

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË MAMURRAS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Mamurras, me objekt: “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënieve me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, vlerësimi i auditit të brendshëm, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 11, datë 27.01.2012 .

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 325/5, datë 27.01.2012, dërguar z. **Dedë NDRECA**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia Bashkiake marrëdhëniet e bashkëpunimit në lidhje me evidentimin dhe ndjekjen e subjekteve të palicencuara dhe subjekteve debitorë ti mbajnë me shkresa nëpërmjet protokollit.

Në vazhdimësi

2. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të marrë masa të menjëhershme për licencimin e subjekteve fizike që ushtrojnë aktivitetet pa leje.

Menjëherë

3. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për subjektet debitorë të nxjerrë njoftimet dhe të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e tyre.

Menjëherë

4. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, për subjektet që kanë deklaruar mbylljen e aktivitetit t'i mbikëqyrë ato periodikisht dhe nëse rezultojnë të kryejnë aktivitet, në bashkërendim me Policinë Bashkiake të bllokojnë aktivitetin deri në reregjistrimin e tyre.

Menjëherë

5. Të sistemohet dhe të rakordohet llogaria 580 arkë-bankë duke bërë korrigjimet përkatëse për vlerat e kontablistuara gabim, të rezultuara nga kontrolli i kryer për vitin 2010 .

Menjëherë

6. Dokumentacioni i plotësuar në lidhje me veprimet e kryera me arkë e bankë të regjistrohet në mënyrë kronologjike.

Në vazhdimësi

7. Në të gjitha procedurat e prokurimeve nga ana e Njësisë së Hartimit të dokumenteve të tenderit të mbahet procesverbal për argumentimin e fondi limit të përcaktuar, dhe miratimin e DST.

Në vazhdimësi

8. Nga Kryetari i KVO, në Raportin Përmbledhës të procedurës së prokurimit të përshkruhen në mënyrë të qartë fazat e vlerësimit të ofertave dhe më pas të nënshkruhet.

Në vazhdimësi

9. Nga Autoriteti Kontraktor në fund të procedurave të prokurimit kontrata e lidhur me operatorin e shpallur fitues duhet të hartohet me të gjithë treguesit e shoqëruar bashkë me Formularin e kontratës, Kushtet e veçanta, Kushtet e përgjithshme dhe të dhëna të tjera të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit.

Në vazhdimësi

10. Nga ana e Bashkisë të merren masat për implementimin e zbatimin e ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” i cili ka hyre në fuqi me datë 30.09.2011.

Menjëherë

11. Dosjet e prokurimeve të inventarizohen e të arkivohen në mënyrë të plotë, me nënshkrime të dorëzuesit dhe arkivistit.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT

1. Të kërkohet arkëtimi në rrugë ligjore i vlerës prej **182 340 lekë** përfituar padrejtësisht nga subjekti ■■■ për punime të pakryera në objektin Rikonstruksion dhe Asfaltim rruga **Gjorm**.

2. Të kërkohet arkëtimi në rrugë ligjore i vlerës prej **51 000 lekë**, për 4 punonjës të policisë Bashkiake përfituar padrejtësisht në tremujorin e IV-të 2010 si më poshtë:

- | | | | | |
|------|-----|---|-------|---------------------|
| 2/1. | ■■■ | me detyrë, ish-inspektor i Policisë Bashkiake | vlera | 24.000 lekë. |
| 2/2. | ■■■ | me detyrë, polic Bashkiak | vlera | 9 000 lekë. |
| 2/3. | ■■■ | me detyrë, ish-Polic Bashkiak | „ | 9 000 lekë |
| 2/4. | ■■■ | me detyrë, Polic Bashkiak | „ | 9 000 lekë |

C. MASA DISIPLINORE

Meqenëse 8 punonjësit të cilët mbajnë përgjegjësi për problemet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, janë të larguar nga puna dhe kanë shkëputur marrëdhëniet e punës e financiare me Bashkinë e qytetit Mamurras, të mos rekomandohen masa disiplinore mbase ato konsiderohen të ezaurura dhe konkretisht për punonjësit e mëposhtëm:

1. ■■■ ish-Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
2. ■■■ ish-anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
3. ■■■ ish-anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
4. ■■■ ish-anëtar i Njesisë së Prokurimit
5. ■■■ ish-anëtar i Njesisë së Prokurimit dhe ish-Drejtor i Financës.
6. ■■■ ish-anëtar i Njesisë së Prokurimit
7. ■■■ ish-anëtar i Njesisë së Prokurimit
8. ■■■ me detyrë ish-Drejtor i Tatim-Taksave.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatos Doda, Agim Mandri, Muhamed Kavaja e Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT